

# DEKRIMINALIZIMI, HETIMET VIP DHE INTEGRITETI I PARTIVE POLITIKE NË SHQIPËRI

RAPORT MONITORIMI



*Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke realizuar projektin “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë përgjegjësi e ISP-së.*

**@Instituti i Studimeve Politike**

**Tiranë, 2026**

**INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE**

**Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)**

**E-mail: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al)**

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Executive Summary .....	4
Përmbledhje Ekzekutive .....	4
Metodologjia.....	5
Gjetjet kryesore.....	6
I. HYRJE.....	6
II. RIVLERËSIMI I DEKRIMINALIZIMIT: ARRITJE DHE KUFIZIME .....	7
III. HETIMET VIP, AKUZAT PENALE DHE PËRGJEGJËSIA POLITIKE E PARTIVE .....	8
IV. PARTITË POLITIKE DHE EROZIONI I INTEGRITETIT .....	10
V. NGA KRIMINALIZIMI I DREJTPËRDREJTË TE NDIKIMI INFORMAL.....	11
VI. BOSHLLËQET LIGJORE DHE KUFIJTË E DEKRIMINALIZIMIT .....	11
VII. AVOKATI I POPULLIT: VAKANCA 44-MUJORE DHE PROBLEMATIKA E ZGJEDHJES .....	12
VIII. RISHIKIMI I RREGULLORES SË KUVENDIT DHE STANDARDET E DEMOKRACISË PARLAMENTARE .....	13
a. Problemet kryesore të draftit.....	14
b. Pasojat për demokracinë parlamentare.....	14
IX. GJETJE TË PËRGJITHSHME NGA MONITORIMI .....	15
X. REKOMANDIME .....	15
XI. PËRFUNDIME .....	16

## Executive Summary

*This report examines key dimensions of political and institutional integrity in Albania, with a particular focus on the interaction between politics, democratic institutions, and the justice system. Prepared within the framework of the project “Promoting Accountability of Elected Officials”, implemented by the Institute for Political Studies (ISP) with the support of the National Endowment for Democracy (NED), the report is based on monitoring conducted during late 2025 and early 2026.*

*The analysis focuses on three interconnected areas. First, it assesses the impact of the decriminalization framework, the rise of high-profile investigations (“VIP cases”), and the persistent weaknesses of political parties in candidate selection. Second, it reviews the prolonged vacancy and contested selection process for the Ombudsperson, as a test of parliamentary responsibility and institutional credibility. Third, it examines the recent attempt to revise the Rules of Procedure of the Assembly following the Constitutional Court decision, with emphasis on transparency, institutional balance, and parliamentary accountability.*

*The report identifies a broader structural problem: while Albania has witnessed progress in criminal accountability and a more active justice system, the political system has not shown a comparable improvement in political responsibility, meritocratic selection, or institutional self-correction. In several cases, reforms and procedures remain formally compliant but substantively weak, allowing political discretion to prevail over constitutional standards and public trust.*

*In this context, the report argues that the challenge of integrity in Albania is no longer only legal. It is equally political, institutional, and cultural. Without deeper internal reform of political parties, stronger parliamentary standards, and greater protection of independent institutions, progress in accountability risks remaining partial, fragmented, and difficult to sustain.*

## Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport analizon disa dimensione kyçe të integritetit politik dhe institucional në Shqipëri, me fokus të veçantë në marrëdhënien midis sistemit politik, institucioneve demokratike dhe sistemit të drejtësisë. I hartuar në kuadër të projektit “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur”, të zbatuar nga Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED), raporti mbështetet në monitorimin e realizuar gjatë fundit të vitit 2025 dhe fillim vitit 2026.

Analiza përqendrohet në tre fusha të ndërlidhura. Së pari, ajo vlerëson ndikimin e ligjit të dekriminalizimit, intensifikimin e hetimeve ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë (“VIP cases”) dhe dobësitë e vazhdueshme të partive politike në përzgjedhjen e kandidatëve. Së dyti, shqyrton vakancën e zgjatur dhe procesin e debatueshëm të zgjedhjes së Avokatit të Popullit, si provë e përgjegjësisë parlamentare dhe e kredibilitetit institucional. Së treti, analizon përpjekjen për rishikimin e Rregullores së Kuvendit pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me theks te transparenca, balanca institucionale dhe llogaridhënia parlamentare.

Raporti evidenton një problem më të gjerë strukturor: ndërsa në Shqipëri është shënuar progres në rritjen e llogaridhënies penale dhe në aktivizimin e sistemit të drejtësisë, sistemi politik nuk ka reflektuar një përmirësim të krahasueshëm në përgjegjësinë politike, në përzgjedhjen meritokratike dhe në aftësinë për vetëkorrigjim institucional. Në disa raste, reformat dhe procedurat rezultojnë formalisht në përputhje me ligjin, por mbeten të dobëta në përmbajtje, duke i lënë hapësirë diskrecionit politik të mbizotërojë mbi standardet kushtetuese dhe besimin publik.

Në këtë kuptim, sfida e integritetit në Shqipëri nuk është më vetëm juridike. Ajo është po aq politike, institucionale dhe kulturore. Pa reformim më të thellë të partive politike, pa standarde më të forta parlamentare dhe pa mbrojtje më të madhe të institucioneve të pavarura, përparimi në llogaridhënie rrezikon të mbetet i pjesshëm, i fragmentuar dhe i vështirë për t’u konsoliduar.

## **Metodologjia**

Ky raport mbështetet në monitorimin e vazhdueshëm të institucioneve, proceseve dhe aktorëve që ndikojnë drejtpërdrejt në integritetin e jetës publike dhe në funksionimin e institucioneve demokratike në Shqipëri. Në këtë kuadër, analiza përfshin institucionet politike, përfshirë Kuvendin e Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe partitë parlamentare, si dhe procese të lidhura me përzgjedhjen e kandidatëve, ushtrimin e përgjegjësisë politike dhe funksionimin e institucioneve të pavarura.

Monitorimi ka marrë në shqyrtim edhe procese specifike me rëndësi institucionale, si zgjedhja e Avokatit të Popullit dhe rishikimi i Rregullores së Kuvendit, në funksion të vlerësimit të standardeve të meritokracisë, transparencës, balancës institucionale dhe respektimit të normave kushtetuese. Në mënyrë paralele, raporti analizon zhvillime që lidhen me hetimet ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë dhe ndërveprimin e tyre me sistemin politik. Analiza mbështetet në të dhëna të mbledhura nga monitorimi periodik, komunikimi me institucionet, dokumente dhe burime zyrtare, vendime publike, raportime mediatike dhe materiale analitike, të përpunuara nga stafi monitorues i ISP.

## Gjetjet kryesore

- I. Dekriminalizimi ka funksionuar si instrument korrigjues, por jo si mekanizëm transformues i sistemit politik.
- II. Partitë politike mbeten hallka më e dobët e sistemit të integritetit, me mungesë filtrash të hershëm dhe efektivë për kandidatët.
- III. Hetimet VIP kanë rritur ndjeshëm llogaridhënien penale, por nuk janë shoqëruar me përgjegjësi politike të krahasueshme.
- IV. Lidhjet midis politikës dhe krimit janë zhvendosur drejt formave më informale dhe më të sofistikuar të ndikimit.
- V. Vakanca 44-mujore për Avokatin e Popullit dëshmon dështim të Kuvendit për të garantuar vazhdimësi institucionale dhe respektim të standardeve kushtetuese.
- VI. Procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit mbetet e ekspozuar ndaj logjikës së kompromisit politik, në dëm të meritokracisë dhe besimit publik.
- VII. Ndryshimet e propozuara në Rregulloren e Kuvendit nuk forcojnë standardet e transparencës, konsultimit publik dhe kontrollit parlamentar, por krijojnë rrezik për përqendrim të mëtejshëm të kontrollit politik.
- VIII. Në tërësi, hendeku midis reformave formale dhe integritetit real institucional mbetet një nga dobësitë kryesore të qeverisjes demokratike në Shqipëri.

### I. HYRJE

Në vitin 2015 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 138/2015 “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”, i njohur si ligji i dekriminalizimit. Ky ligj erdhi si përgjigje ndaj shqetësimeve të theksuara, si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe vendas, për depërtimin e individëve me të shkuar kriminale në institucionet shtetërore dhe në përfaqësimin politik. Raporti i Freedom House (2015) evidentonte se lidhjet e krimit të organizuar po ndikonin negativisht në funksionimin demokratik të vendit, ndërsa OSCE/ODIHR theksonte ndikimin e këtyre aktorëve në proceset zgjedhore përmes blerjes së votës dhe frikësimit të votuesve.

Në këtë kontekst, integriteti i zyrtarëve publikë dhe, në veçanti, i kandidatëve të partive politike, u shndërrua në një çështje themelore për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe për procesin e integritetit europian. Instituti i Studimeve Politike (ISP), ka vijuar

monitorimin sistematik të këtij dimensioni, duke analizuar praktikat e përzgjedhjes së kandidatëve, zbatimin e legjislacionit për integritetin dhe zhvillimet në raport me hetimet ndaj zyrtarëve të lartë. Të dhënat dhe gjetjet e paraqitura në këtë raport lidhen kryesisht me periudhën e fundit të vitit 2025 dhe vijimin e saj gjatë fillim vitit 2026, duke reflektuar dinamikat më të fundit të ndërveprimit midis politikës, drejtësisë dhe standardeve të integritetit në Shqipëri.

Në stadin aktual të zhvillimit të Shqipërisë, ku procesi i integritetit evropian dhe konsolidimi i shtetit të së drejtës janë të ndërvarur, nevoja për një politikë të pastër dhe për zyrtarë me integritet nuk është më thjesht një standard normativ, por një kusht strategjik për stabilitetin institucional dhe besimin publik. Një sistem politik që prodhon dhe toleron individë me risk integriteti dobëson kapacitetin e shtetit për të zbatuar ligjin, dëmton konkurrencën e ndershme politike dhe minon legjitimitetin e institucioneve.

Në këtë drejtim, qëndrimet e partnerëve ndërkombëtarë, veçanërisht të Shteteve të Bashkuara, kanë qenë të qarta dhe konsistente: lufta kundër korrupsionit në nivele të larta dhe ndëshkimi i zyrtarëve të përfshirë në abuzime përbëjnë një prioritet kyç për forcimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Siç theksohet në komunikimet zyrtare të Departamentit Amerikan të Shtetit, *“accountability for corrupt officials is essential to strengthening democratic institutions and advancing rule of law”*<sup>1</sup>, një qasje që është reflektuar edhe në përdorimin e mekanizmave si sanksionet sipas nenit 7031(c)<sup>2</sup> për zyrtarë të përfshirë në korrupsion madhor.

Në këtë kuptim, ndërtimi i një kulture politike të bazuar në integritet nuk është vetëm një kërkesë e brendshme demokratike, por edhe një pritshmëri e qartë e partnerëve strategjikë të Shqipërisë dhe një kusht thelbësor për avancimin e saj në rrugën europiane.

## **II. RIVLERËSIMI I DEKRIMINALIZIMIT: ARRITJE DHE KUFIZIME**

Ligji i dekriminalizimit prodhoi efekte të menjëhershme dhe të matshme në pastrimin formal të institucioneve publike. Ai çoi në largimin e një numri të konsiderueshëm individësh nga Kuvendi dhe nga organet e pushtetit vendor, duke vendosur për herë të parë një standard minimal të detyrueshëm për integritetin në funksionet publike. Në vijim, partitë politike miratuan kode etike dhe mekanizma formalë për filtrimin e kandidatëve, duke reflektuar presionin institucional dhe ndërkombëtar për rritjen e standardeve të përfaqësimit.

---

<sup>1</sup> <https://www.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

<sup>2</sup> U.S. Department of State. (2024). Section 7031(c), FY 2024 Department of State, Foreign Operations, and Related Programs Appropriations Act. <https://al.usembassy.gov/>

Megjithatë, një dekadë pas hyrjes në fuqi të ligjit, evidencat nga monitorimi tregojnë se këto masa nuk kanë prodhuar një transformim të qëndrueshëm të kulturës politike. Integriteti vijon të trajtohet kryesisht si një detyrim ligjor dhe procedural, ndërsa mungon internalizimi i tij si standard politik dhe etik në funksionimin e përditshëm të partive.

Në praktikë, partitë politike kanë dështuar të ndërtojnë mekanizma të qëndrueshëm, të hershëm dhe efektivë për verifikimin paraprak të kandidatëve. Procesi i filtrimit mbetet kryesisht reaktiv, i varur nga ndërhyrjet ex-post të institucioneve të drejtësisë, presioni i medias dhe reagimi i aktorëve ndërkombëtarë, në vend që të jetë pjesë integrale e vendimmarrjes politike.

Si rezultat, dekriminalizimi ka funksionuar si një instrument i domosdoshëm korrigjues, por jo si një mekanizëm transformues i sistemit politik. Ai ka kufizuar përfshirjen e individëve me precedent penal, por nuk ka arritur të ndryshojë mënyrën sesi partitë përzgjedhin dhe promovojnë elitat e tyre. Në këtë kuptim, kufijtë e dekriminalizimit nuk lidhen më vetëm me zbatimin e tij, por me mungesën e një kulture të brendshme integriteti që ta bëjë atë të panevojshëm si ndërhyrje emergjente.

### **III. HETIMET VIP, AKUZAT PENALE DHE PËRGJEGJËSIA POLITIKE E PARTIVE**

Një nga zhvillimet më të rëndësishme në Shqipëri gjatë viteve të fundit është intensifikimi i hetimeve ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë (“VIP cases”), të cilat kanë shënuar një kthesë të dukshme në luftën kundër korrupsionit. Për herë të parë, struktura të posaçme si SPAK dhe GJKKO kanë zhvendosur fokusin nga korrupsioni periferik drejt niveleve më të larta të vendimmarrjes politike dhe administrative, duke vendosur nën hetim figura me peshë reale në sistemin politik (Gjeta, 2025).

Institucionet e drejtësisë kanë ndërmarrë veprime konkrete, duke mbyllur hetime dhe duke dërguar në gjykatë çështje të rëndësishme, si dhe duke komunikuar akuza ndaj zyrtarëve të lartë, përfshirë drejtues të pushtetit vendor. Këto zhvillime përfaqësojnë një progres të qartë në rritjen e llogaridhënies penale dhe në forcimin e kapaciteteve të shtetit për të ndjekur korrupsionin në nivele të larta (Gjeta, 2025).

Megjithatë, ky progres në drejtësi nuk është shoqëruar me një reflektim të ngjashëm në sistemin politik. Përkundrazi, analiza e rasteve konkrete tregon një realitet problematik: individë nën hetim, në procese gjyqësore apo me akuza të rënda vijnë të jenë pjesë e strukturave partiake, të kandidohen në zgjedhje dhe, në disa raste, të fitojnë mandate përfaqësuese. Ky fenomen është evidentuar në disa zona zgjedhore me risk të lartë, ku kandidatët me probleme integriteti janë përfshirë në lista dhe kanë marrë mbështetje elektorale (ISP, 2025, cit. në Gjeta, 2025).

Rastet konkrete të referuara në këtë raport janë domethënëse. Një zyrtar i lartë publik është akuzuar për *“korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”*, *“shpërdorimi i detyrës”* dhe *“falsifikim i dokumenteve”* (BalkanWeb, 2024, cit. në Gjeta, 2025), ndërsa një ish-deputet është dërguar për gjykim për *“abuzime me tenderat e projektimit të komisariateve të policisë”* (Reporter.al, 2024, cit. në Gjeta, 2025).

Këto nuk janë raste të izoluara. Ato tregojnë një model të qëndrueshëm ku pushteti publik përdoret për përfitime private dhe ku vendimmarrja politike ndërthuret me interesa ekonomike dhe rrjete klienteliste.

Problemi bëhet edhe më serioz kur këto raste nuk prodhojnë pasoja politike. Edhe në situata kur ekzistojnë akuza formale apo masa sigurie, individët në fjalë nuk përjashtohen automatikisht nga jeta politike. Përkundrazi, ata vazhdojnë të jenë pjesë e elitave partiake ose të mbështeten prej tyre. Kjo krijon një standard të dyfishtë: drejtësia vepron, por politika nuk reagon.

Në këtë kontekst, evidentohet qartë një krizë e thellë e përgjegjësisë politike. Partitë politike, si aktorët kryesorë të përzgjedhjes së kandidatëve dhe të prodhimit të elitave, nuk po funksionojnë si filtra integriteti, por në shumë raste si mekanizma që e tolerojnë ose e absorbojnë riskun e korrupsionit.

Rekomandimet ndërkombëtare janë të qarta në këtë drejtim. OSCE/ODIHR thekson nevojën për *“verifikim më efektiv dhe në kohë të formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve”* si dhe për përforcimin e mekanizmave të brendshëm të partive për kontrollin e integritetit (OSCE/ODIHR, 2021, cit. në Gjeta, 2025).

Në përfundim, hetimet VIP kanë dëshmuar se sistemi i drejtësisë në Shqipëri ka filluar të funksionojë në nivele më të larta llogaridhënieje. Por ato kanë zbuluar gjithashtu kufirin kryesor të reformave: mungesën e përgjegjësisë politike. Pa një transformim real të partive politike në institucione që garantojnë integritetin e kandidatëve dhe të përfaqësimit, lufta kundër korrupsionit rrezikon të mbetet e pjesshme, selektive dhe e përkohshme.

Në thelb, sfida nuk është më vetëm të ndëshkohen individët, por të reformohet sistemi politik që i prodhon dhe i mbron ata.

#### IV. PARTITË POLITIKE DHE EROZIONI I INTEGRITETIT

Monitorimi evidenton në mënyrë të qartë se partitë politike përbëjnë hallkën më të dobët të sistemit të integritetit në Shqipëri. Ndryshe nga progresi i dukshëm në rritjen e kapaciteteve hetimore dhe ndëshkuese të institucioneve të drejtësisë, sistemi politik nuk ka zhvilluar mekanizma të brendshëm të krahasueshëm për garantimin e integritetit të përfaqësimit. Përkundrazi, praktika e përzgjedhjes së kandidatëve tregon një tolerancë të vazhdueshme ndaj individëve me risk të lartë integriteti.

Të dhënat e monitorimit tregojnë se në zgjedhjet e fundit janë përfshirë në lista kandidatë që rezultojnë nën hetim nga SPAK, individë në procese gjyqësore, si dhe persona me lidhje të dyshuara me rrjete kriminale ose me individë të përfshirë në skema të sanksioneve ndërkombëtare (ISP, 2025; Reporter.al, 2025, cit. në Gjeta, 2025).

Ky fenomen është evidentuar në disa nga qarqet më të rëndësishme elektorale, si Durrësi, Tirana, Elbasani dhe Shkodra, ku përfshirja e kandidatëve me probleme integriteti nuk përbën raste sporadike, por një model të përsëritur sjelljeje politike. Prania e tyre në lista zgjedhore dhe, në disa raste, edhe suksesi elektoral, dëshmon për mungesën e filtrave efektivë të verifikimit brenda partive dhe për një standard të ulët të përgjegjësisë politike.

Në këtë kontekst, problemi nuk është thjesht juridik. Edhe pse kuadri ligjor, përfshirë ligjin për dekriminalizimin, vendos kufizime të qarta për individët me precedent penal, ai nuk adreson në mënyrë të plotë kategoritë gri: si personat nën hetim, në proces gjyqësor apo me lidhje informale me struktura kriminale. Kjo hapësirë lejon partitë politike të operojnë në kufijtë e ligjshmërisë formale, duke anashkaluar standardet e integritetit real.

Siç theksohet edhe në rekomandimet ndërkombëtare, nevoja për “*verifikim më efektiv dhe në kohë*” të kandidatëve dhe për forcimin e mekanizmave të brendshëm të partive mbetet një prioritet kyç për integritetin e proceseve zgjedhore (OSCE/ODIHR, 2021, cit. në Gjeta, 2025).

Në thelb, përfshirja e kandidatëve me risk të lartë integriteti nuk përfaqëson vetëm një dështim teknik të verifikimit, por një tregues të një kulture politike ku integriteti nuk trajtohet si kriter themelor për përzgjedhjen dhe promovimin e elitave. Kjo kulturë minon besimin publik në përfaqësimin politik, dobëson cilësinë e demokracisë dhe krijon një cikël vetë-riprodhues të elitave me standarde të ulëta llogaridhënieje.

Në këtë kuptim, sfida kryesore nuk qëndron vetëm në përmirësimin e kuadrit ligjor, por në transformimin e vetë partive politike në institucione që garantojnë integritetin,

transparencën dhe përgjegjësinë në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve. Pa këtë transformim, çdo progres në nivel penal mbetet i pjesshëm dhe i paqëndrueshëm.

## **V. NGA KRIMINALIZIMI I DREJTPËRDREJTË TE NDIKIMI INFORMAL**

Një nga zhvillimet më të rëndësishme të evidentuara nga monitorimi lidhet me transformimin e natyrës së marrëdhënieve midis politikës dhe krimit. Nëse në fazat e mëparshme problematika lidhej kryesisht me përfshirjen direkte të individëve me precedent penal në politikë, aktualisht vihet re një zhvendosje drejt formave më të sofistikuara dhe më pak të dukshme të ndërveprimit.

Në vend të ekspozimit të drejtpërdrejtë, aktorët politikë dhe ata me interesa kriminale operojnë përmes mekanizmave indirektë, si përdorimi i personave të tretë, mbështetja elektorale informale dhe ndërtimi i marrëdhënieve klienteliste që ndikojnë në vendimmarrjen politike. Këto forma bashkëpunimi nuk janë gjithmonë të dokumentueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, por janë identifikuar përmes analizave të zonave zgjedhore me risk dhe dinamikave të ndikimit elektorale (Reporter.al, 2025; ISP, 2025, cit. në Gjeta, 2025).

Ky transformim përfaqëson një evolucion të fenomenit: nga një model i dukshëm dhe i sanksionueshëm ligjor, drejt një modeli të fragmentuar dhe të shpërndarë, ku ndikimi realizohet përmes rrjeteve informale dhe ndërmjetësve. Në këtë mënyrë krijohet një “zonë gri” midis ligjshmërisë formale dhe integritetit real, ku aktorët politikë mund të respektojnë formalisht ligjin, por të operojnë në mënyra që cenojnë thelbin e tij.

Si rezultat, ndërhyrja vetëm përmes instrumenteve ekzistuese ligjore rezulton e pamjaftueshme. Ligji mund të përjashtojë individë me precedent penal, por ka vështirësi në adresimin e ndikimit të rrjeteve informale, të cilat shpesh janë më të qëndrueshme dhe më të vështira për t’u provuar. Kjo e zhvendos sfidën nga një problem penal në një problem më të gjerë të integritetit politik dhe të cilësisë së demokracisë.

## **VI. BOSHLLËQET LIGJORE DHE KUFIJTË E DEKRIMINALIZIMIT**

Kuadri ligjor ekzistues, veçanërisht ligji për dekriminalizimin, ka luajtur një rol të rëndësishëm në kufizimin e përfshirjes së individëve me precedent penal në jetën politike. Megjithatë, monitorimi evidenton se ky ligj mbetet i fokusuar kryesisht në kriteret formale, të lidhura me ekzistencën e dënimeve penale, dhe nuk adreson në mënyrë të plotë dimensionet më komplekse të integritetit politik.

Në praktikë, boshllëqet ligjore shfaqen në disa drejtime kryesore. Së pari, ligji nuk

trajton në mënyrë të mjaftueshme lidhjet e papërshtatshme midis aktorëve politikë dhe individëve apo grupeve me aktivitet kriminal. Së dyti, mekanizmat për identifikimin dhe menaxhimin e konflikteve të interesit mbeten të dobëta dhe shpesh të paefektshme në nivel politik. Së treti, ndikimet informale të krimit në proceset politike – përmes financimit, mbështetjes elektorale apo presionit në zona të caktuara – mbeten jashtë fushës së drejtpërdrejtë të ndërhyrjes ligjore (OSCE/ODIHR, 2021; ISP, 2025, cit. në Gjeta, 2025).

Si pasojë, krijohet një situatë ku individë formalisht “*të pastër*” nga pikëpamja ligjore mund të jenë pjesë e sistemit politik, ndërkohë që në praktikë cenojnë standardet e integritetit përmes lidhjeve dhe ndikimeve joformale. Kjo dobëson efektivitetin e ligjit dhe krijon një hendek midis qëllimit të tij dhe zbatimit real.

Në këtë kontekst, kufijtë e dekriminalizimit nuk lidhen më vetëm me zbatimin e tij, por me vetë dizajnin e tij normativ. Një qasje e fokusuar vetëm në të kaluarën penale të individëve nuk është e mjaftueshme për të garantuar integritetin e sistemit politik në kushtet e transformimit të formave të ndikimit.

Për rrjedhojë, sfida kryesore që del nga monitorimi është nevoja për një qasje më të gjerë dhe më të integruar ndaj integritetit politik, e cila të përfshijë jo vetëm ndalimin e individëve me precedent penal, por edhe rregullimin dhe kontrollin e marrëdhënieve, interesave dhe ndikimeve që veprojnë në mënyrë informale brenda sistemit politik.


## VII. AVOKATI I POPULLIT: VAKANCA 44-MUJORE DHE PROBLEMATIKA E ZGJEDHJES

Kuvendi i Shqipërisë, pas një vakance rreth 44-mujore, zhvilloi procesin për zgjedhjen e Avokatit të Popullit. Institucioni i Avokatit të Popullit përbën një rast tipik ku formula e kompromisit politik ka dominuar mbi formulën kushtetuese të konkurrimit dhe meritokracisë. Kjo e dobëson kuptimin e pavarësisë institucionale dhe cenon besimin publik të procedurës.

**Problematika e procedurës së zgjedhjes:** Ndonëse ligji parashikon garë të lirë, ai detyron kandidatët të marrin minimumi 28 firma mbështetëse nga deputetët, ndërkohë që një deputet mund të firmosë për një numër të pakufizuar kandidatësh. Kjo krijon një hapësirë spekulimi dhe formalizmi, si dhe vendos kandidatët në nevojën për të krijuar lidhje dhe pakte personale politike në këmbim të mbështetjes.

Aktualisht disa prej kandidatëve vijnë nga poste drejtuese politike dhe disa nga strukturat e vetingut dhe të drejtësisë. Në këtë kontekst, problemi nuk lidhet vetëm me legjitimitetin formal të kandidimit, por me standardin e integritetit, profilin profesional dhe besimit publik që duhet të mishërojë drejtuesi i këtij institucioni.

**Ndryshimi i qëndrimeve politike dhe brishtësia institucionale:** Tabela e krijuar nga stafi monitorues i ISP paraqet historikun e drejtuesit të AP ndër vite. Procedura e vitit 2022 rezultoi e pasuksesshme, pasi mazhoranca e asaj kohe refuzoi kompromisin dhe produktin e zgjedhur nga opozita. Në vitin 2025, e njëjta mazhorancë ka ndryshuar qëndrim dhe ka pranuar formulën e kompromisit politik, ndërsa opozita ka ndryshuar gjithashtu sjellje, duke tërhequr në momentin e fundit firmat mbështetëse për disa kandidatë.



Këto zhvillime përbëjnë tregues të brishtësisë së institucioneve dhe të mënyrës sesi norma kushtetuese dhe ligjore mbeten të ekspozuara ndaj interesave dhe kalkulimeve politike.

## VIII. RISHIKIMI I RREGULLORES SË KUVENDIT DHE STANDARDET E DEMOKRACISË PARLAMENTARE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e datës 10.02.2026, shfuqizoi vendimin nr. 57/2025 të Kuvendit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 ‘Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar’”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim përbën një akt me rëndësi të veçantë për legjislaturën aktuale dhe e detyron Kuvendin të rishikojë praktikën e tij në përputhje me parimet dhe detyrimet kushtetuese. Rregullorja e Kuvendit është një akt themelor jo vetëm për funksionimin e parlamentit,

por edhe për jetësimin e parimeve të shtetit të së drejtës dhe demokracisë funksionale.

**Mungesa e vizionit reformues:** ISP ka monitoruar dhe adresuar sugjerime përmirësuese lidhur me Rregulloren, përfshirë edhe elementët që u rrëzuan nga Gjykata Kushtetuese. Pritshmëria ka qenë që rishikimi i Rregullores të përfshijë edhe plotësime të kuadrit rregullator të Kuvendit, përfshirë Kodin e Sjelljes dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi mbi integrimin, lobimin, konsultimin publik, konfliktin e interesit dhe dekriminalizimin. Megjithatë, drafti i ri me ndryshime u bazua kryesisht në nevojat ditore të aktivitetit parlamentar dhe jo në një vizion afatgjatë për një parlament më të hapur, më funksional, më të besueshëm dhe më efektiv.

#### **a. Problemet kryesore të draftit**

*Nisma për ndryshime:* Ndryshimet janë iniciuar nga tre deputetë, shumica e të cilëve nuk janë pjesë e strukturave përgjegjëse për çështjet e rregullores dhe ligjvënies. Kjo e bën nismën të duket më shumë politike sesa produkt i një analize profesionale dhe strukturorë në parlament.

*Procedura e përshpejtuar dhe mungesa e konsultimit:* Përcaktimi në Rregullore i procedurës së përshpejtuar për aktet lidhur me integrimin reflekton ndryshimet ligjore, por nuk garanton se kjo procedurë nuk cenon detyrimet për transparencë dhe konsultim publik. Në të njëjtën kohë, drafti nuk ofron mekanizma të rinj për përfshirjen e publikut dhe shoqërisë civile.

*Përqendrimi i rolit të komisionit të mbikëqyrjes institucionale:* Drafti i ri i jep rol dominues Komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale, duke dobësuar rolin e komisioneve të tjera të përhershme parlamentare. Kjo vihet re në Kontrollin Post-Legjislativ, në raportimin e institucioneve të pavarura, në thirrjen e tyre në seancë plenare dhe në trajtimin e peticioneve.

*Dobësimi i transparencës publike:* Ndërkohë që lista e kandidatëve për organe kushtetuese apo të krijuara me ligj mbetet publike, drafti nuk garanton publikimin e CV-ve, formularëve të dekriminalizimit dhe të dhënave të tjera thelbësore. Kjo e kufizon transparencën reale të procesit.

#### **b. Pasojat për demokracinë parlamentare**

Në tërësi, drafti i ndryshimeve nuk garanton standard të ri të modelit të BE-së dhe nuk forcon kontrollin parlamentar, transparencën apo përfshirjen publike. Përkundrazi, ekziston rreziku që praktikat e gabuara të së kaluarës, të bazuara në dispozita evazive dhe procedura të njëanshme, të përsëriten.

Në këtë kuptim, rishikimi i Rregullores mbetet një test i rëndësishëm për vullnetin e

Kuvendit për të funksionuar si institucion qendror i përfaqësimit, llogaridhënies dhe integritetit evropian.

## **IX. GJETJE TË PËRGJITHSHME NGA MONITORIMI**

Monitorimi konfirmon se, pavarësisht progresit të dukshëm në kuadrin ligjor dhe në rritjen e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë, sistemi i integritetit në Shqipëri mbetet i brishtë dhe i fragmentuar. Zbatimi i ligjit nr. 138/2015 vijon të jetë kryesisht formal dhe i orientuar drejt reagimit pas faktit, duke munguar një qasje parandaluese e bazuar në standarde të brendshme integriteti, veçanërisht në partitë politike.

Në këtë kuadër, një nga gjetjet më të rëndësishme është se partitë politike nuk kanë zhvilluar mekanizma efektivë dhe në kohë për verifikimin e kandidatëve. Ato vazhdojnë të funksionojnë si hallka më e dobët e sistemit, duke lejuar përfshirjen në lista zgjedhore të individëve me risk të lartë integriteti, përfshirë persona nën hetim, në procese gjyqësore apo me lidhje të dyshuara me rrjete kriminale.

Kjo situatë reflekton një hendek të thellë midis standardeve ligjore dhe praktikave reale politike. Ndërsa ligji synon të garantojë një përfaqësim të pastër dhe të besueshëm, praktikatat e përzgjedhjes së kandidatëve tregojnë se integriteti nuk është ende një kriter thelbësor në vendimmarrjen politike.

Një tjetër gjetje thelbësore lidhet me transformimin e marrëdhënieve midis politikës dhe kimit. Nga format e drejtpërdrejta të përfshirjes së individëve me precedent penal, vihet re një zhvendosje drejt formave më të sofistikuara dhe informale të ndikimit, përfshirë mbështetjen elektorale indirekte, lidhjet klienteliste dhe përdorimin e ndërmjetësve. Ky transformim krijon një zonë gri midis ligjshmërisë formale dhe integritetit real, duke e bërë më të vështirë ndërhyrjen vetëm përmes instrumenteve ekzistuese ligjore.

Në të njëjtën kohë, hetimet ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë kanë rritur ndjeshëm nivelin e llogaridhënies penale, duke shënuar një zhvillim pozitiv në funksionimin e shtetit të së drejtës. Megjithatë, këto zhvillime nuk janë shoqëruar me një rritje të krahasueshme të përgjegjësisë politike. Edhe në raste të hetimeve apo akuzave formale, reagimi i partive politike mbetet i kufizuar ose i munguar, duke krijuar një standard të dyfishtë midis drejtësisë dhe politikës.

## **X. REKOMANDIME**

- I. Partitë politike duhet të zhvillojnë mekanizma të detyrueshëm dhe transparentë për verifikimin paraprak të kandidatëve, duke e kthyer integritetin në kriter

themelor të përzgjedhjes.

- II. Kuadri ligjor i dekriminalizimit duhet të rishikohet për të adresuar jo vetëm precedentët penalë, por edhe lidhjet e papërshtatshme, konfliktet e interesit dhe format informale të ndikimit kriminal në politikë.
- III. Kuvendi duhet të garantojë respektimin e afateve kushtetuese dhe ligjore për plotësimin e vakancave në institucionet e pavarura, duke shmangur zgjatjen e pajustificuar të tyre.
- IV. Procedurat për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të institucioneve të tjera të pavarura duhet të orientohen më shumë nga meritokracia, transparenca dhe besimi publik, dhe më pak nga kompromisi politik.
- V. Rishikimi i Rregullores së Kuvendit duhet të bëhet mbi bazën e një pakete të plotë reformuese, që forcon kontrollin parlamentar, konsultimin publik, rolin e komisioneve dhe transparencën e vendimmarrjes.
- VI. Duhet të shmangen formulimet evazive që lejojnë diskrecion të gjerë politik dhe të zëvendësohen me standarde të qarta, të njësuara dhe të verifikueshme.
- VII. Shoqëria civile, media dhe komuniteti akademik duhet të kenë rol më të fortë në monitorimin e integritetit të jetës publike dhe të proceseve parlamentare.

## **XI. PËRFUNDIME**

Ky raport tregon se sfida e integritetit në Shqipëri nuk kufizohet më vetëm te depërtimi i individëve me precedent penal në politikë. Ajo lidhet gjithnjë e më shumë me mënyrën sesi funksionojnë partitë politike, me aftësinë e Kuvendit për të respektuar standardet kushtetuese dhe me cilësinë e procedurave për garantimin e pavarësisë institucionale.

Hetimet VIP kanë dëshmuar një rritje të ndjeshme të llogaridhënies penale. Megjithatë, kjo nuk është shoqëruar me përgjegjësi politike të krahasueshme. Në të njëjtën kohë, vakanca shumëvjeçare e Avokatit të Popullit dhe dobësitë e draftit për Rregulloren e Kuvendit evidentojnë se institucionet demokratike mbeten ende të cenueshme ndaj logjikës së kompromisit politik, diskrecionit dhe mungesës së meritokracisë.

Në thelb, sfida kryesore mbetet e njëjtë: transformimi i standardeve formale në integritet real institucional dhe politik. Pa këtë transformim, përparimi në nivel penal dhe juridik rrezikon të mbetet i pjesshëm dhe i paqëndrueshëm.